



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 17, datë 12.04.2017

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT TË OBJEKTIT:
“GODINË BANIMI DHE SHËRBIMESH 3 DHE 7-8 KATE DHE 2 KATE NËNTOKË”,
ME VENDNDODHJE NË RRUGËN E DIBRËS, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, nenit 17 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “Orion” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit të objektit: “Godinë banimi dhe shërbimesh 3 dhe 7-8 kate dhe 2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën e Dibrës, Bashkia Tiranë, miratuar me Vendimin Nr. 16, datë 09.09.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit, me subjekt zhvillues shoqërinë “Orion” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 16, datë 09.09.2015, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR IKKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETARI KKT

LEDIA TOFA

DREJTORI AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

